



Republika e Kosovës
Republika Kosovo - Republic of Kosovo



Autoriteti i Aviacionit Civil i Kosovës
Autoritet Civilnog Vazduhoplovstva Kosova
Civil Aviation Authority of Kosovo

Raporti për përcaktimin e tarifës njësi terminale për vitin 2017 - Kosovë

Prishtinë, nëntor 2016

Përmbajtja

1.	Hyrje.....	4
2.	Baza ligjore.....	4
3.	Informacion i përgjithshëm për OSHNA-n e Kosovës - ASHNA.....	5
4.	Metodologjia dhe parimet e tarifimit	6
5.	Kostot e pranueshme.....	6
6.	Llogaritja e tarifës terminale.....	7
7.	Vlerësimi i aplikacionit të ASHNA-s.....	7
7.1.	Vlerësimi dhe përcaktimi i kostove të stafit dhe atyre operative.....	8
7.2.	Vlerësimi dhe përcaktimi i zhvlerësimit dhe kostoja e kapitalit	9
7.2.1.	Baza e aseteve.....	9
7.3.	Zhvlerësimi	9
7.3.1.	Zhvlerësimi i aseteve ekzistuese	10
7.3.2.	Zhvlerësimi i aseteve të reja	10
7.4.	Kostoja e kapitalit.....	12
7.4.1.	Kostoja e kapitalit të aseteve ekzistuese	14
7.4.2.	Kostoja e kapitalit për asetet e reja	14
7.5.	Kostot totale të zhvlerësimit dhe kostoja totale e kapitalit.....	15
8.	Vlerësimi dhe përcaktimi i kostove totale	15
9.	Parashikimi i trafikut	16
9.1.	Rritja ekonomike dhe inflacioni	16
9.2.	Trafiku ndër vite.....	17
9.3.	Supozimet e trafikut.....	19
9.4.	Rritja e parashikuar e trafikut	19
10.	Tarifa njësi.....	20
11.	Përfundim	21

Lista e tabelave

Tabela 1. Propozimi i ASHNA-s dhe përcaktimi i AAC-së për kostot e stafit dhe operative	8
Tabela 2. Asetet fikse që do të jenë në operim gjatë vitit 2017 të propozuara nga ASHNA dhe të përcaktuara nga AAC-ja	9
Tabela 3. Përcaktimi i kostove të zhvlerësimit për asetet ekzistuese	10
Tabela 4. Lista e asetëve të planifikuara për periudhën e ardhshme 3 vjeçare	11
Tabela 5. Kostoja e zhvlerësimit për asetet e reja	12
Tabela 6. Kostoja e kapitalit të asetëve ekzistuese siç është propozuar nga ASHNA në krahasim me përcaktimin e AAC-së.....	14
Tabela 7. Kostoja e kapitalit për asetet e reja	14
Tabela 8. Kostot totale të propozuara nga ASHNA, në krahasim me ato të përcaktuara nga AAC-ja.....	15
Tabela 9. Tarifa njësi për TNC të Kosovës, e propozuar nga ASHNA, në krahasim me atë të përcaktuar nga AAC-ja.....	20

Lista e figurave

Figura 1. Kostot për vitin 2017, të propozuara nga ASHNA, në krahasim me ato të përcaktuara nga AAC-ja.....	16
Figura 2. Numri i udhëtarëve në ANP Adem Jashari për periudhën 2000-2015.....	18
Figure 3. Numri i fluturimeve në ANP Adem Jashari për periudhën 2000-2015	18

1. Hyrje

Ky raport është përgatitur nga Autoriteti i Aviacionit Civil i Republikës së Kosovës (AAC) me qëllim të konsultimit, pas aplikimit të Ofruesit të Shërbimit të Navigacionit Ajror (OSHNA) për të përcaktuar tarifën njësi terminale të navigacionit për vitin 2017 për shërbimet terminale të navigacionit që ata i ofrojnë në hapësirën ajrore të Republikës së Kosovës. Përcaktimi përfundimtar nga AAC-ja do të bëhet pas shqyrtimit të komenteve të pranuar gjatë këtij procesi të konsultimit.

2. Baza ligjore

Në përputhje me nenin 81 *Tarifat për Shfrytëzim* të Ligjit për Aviacionin Civil, AAC-ja nxjerr rregullore zbatuese që përcaktojnë tarifën që duhet t'u ngarkohen pronarëve dhe operatorëve të avionëve për shfrytëzimin e çdo shërbimi ose objekti të ofruar nga Ofruesi i Shërbimeve të Navigacionit Ajror. Përmes Rregullores nr. 3/2016, AAC-ja ka transpozuar plotësisht Rregulloren e KE-së nr. 1794/2006 mbi skemën e përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror, të njohur gjithashtu si "rregullore për mbulimin e plotë të kostove", në bazë të së cilës OSHNA e Kosovës do të jetë në gjendje të mbulojë të gjitha shpenzimet e bëra në mënyrë të drejtpërdrejtë ose të tërthortë në ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror.

Ky është viti i parë i zbatimit të rregullores së re. Kjo rregullore përcakton metodologjinë për llogaritjen e kostove të pranueshme, parimet e skemës së tarifimit si dhe procesin e miratimit, duke filluar nga paraqitja e Tabelave të Raportimit nga OSHNA deri në përcaktimin përfundimtar të tarifës njësi nga AAC-ja. Pasi që ofrimi i shërbimeve në hapësirën e lartë ajrore të Kosovës i është deleguar Hungarisë nga NATO deri në vitin 2019, i mundësuar nga Hungarocontrol, ky dokument ka të bëjë vetëm me përcaktimin e tarifës terminale të navigacionit. Për shkak se Komisioni Evropian (KE) është duke planifikuar që të përfshijë të gjithë partnerët e Hapësirës së Përbashkët Evropiane të Aviacionit (HPEA) në skemën e performancës së shërbimeve të navigacionit ajror që nga Periudha Referuese 3 në vitin 2020, AAC-ja është këshilluar nga KE-ja për të filluar menjëherë zbatimin e "rregullores për mbulim të plotë të kostove", në mënyrë që të mbledhen të dhëna historike dhe të bëhet familjarizimi me parimet dhe mekanizmin e tarifimit, që të jemi të gatshëm për metodën e kostove të përcaktuara, e cila duhet të zbatohet prej vitit 2020.

Për shkak të arsyeve politike jashtë kontrollit të AAC-së, Republika e Kosovës nuk është shtet anëtar i EUROCONTROL-it, prandaj ky proces i konsultimit është duke u ndërmarrë ndarazi nga sistemi i themeluar nga EUROCONTROL-i për konsultim dhe përcaktim të tarifave njësi në emër të shteteve të veta anëtare. Megjithatë, siç mund të vërtetohet më poshtë, manualët e EUROCONTROL-it mbi tarifën e rrugëve ajrore dhe mbi parimet e tarifimit janë konsultuar gjerësisht gjatë vlerësimit të aplikacionit të ASHNA-s. Ka pasur komunikim edhe me CRCO-në (*Central Route Charges Office*) dhe zyrën SES (*Single European Sky*) të KE-së. AAC-ja është duke punuar me EUROCONTROL-in për të zyrtarizuar një lloj bashkëpunimi që do të përfshinte çështjet e tarifimit.

3. Informacion i përgjithshëm për OSHNA-n e Kosovës - ASHNA

Agjencia për Shërbimet e Navigacionit Ajror (ASHNA) është një agjenci e pavarur qeveritare e cila ofron shërbime të navigacionit ajror brenda Republikës së Kosovës. Siç u shpjegua më lart, ASHNA ofron vetëm shërbime terminale të navigacionit. ASHNA është një organizatë e pavarur buxhetore dhe autoritet publik dhe ka buxhetin e saj që menaxhohet në mënyrë të pavarur. ASHNA është e ndarë në aspektin funksional dhe organizativ nga AAC-ja. ASHNA është themeluar përmes Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror që nga fillimi i këtij viti.

Gjendja financiare e ASHNA-s nuk ka qenë e qëndrueshme në katër vitet e fundit si rezultat i humbjeve financiare për shkak të borxheve të trashëguara nga entiteti i mëhershëm juridik dhe pamundësia për të gjeneruar të hyra nga hapësira e lartë ajrore. Rrjedhimisht, ASHNA është duke kaluar nga vitet e mëparshme me investime të pamjaftueshme kapitale. Megjithatë, që nga transformimi nga një ndërmarrje publike në një agjenci shtetërore në vitin 2016, ASHNA ka një pozitë më të fortë financiare për shkak të mundësisë që qeveria të intervenojë në rast të humbjeve si dhe për shkak të kualifikueshmërisë për grante shtetërore për investime kapitale. AAC-ja dëshiron të theksojë që viti 2017 do të jetë viti i parë i zbatimit të regjimit të mbulimit të plotë të kostove në ASHNA. Si përfundim, fakti që jemi në periudhën kur ASHNA është e varur nga rregullat e buxhetit të shtetit dhe në të njëjtën kohë është duke u përpjekur që t'i përshtatet operacionit të mbulimit të plotë të kostove, krijon disa paqartësi për të ardhmen, të cilat besojmë që do të zgjidhen gjatë vitit 2017.

Që nga ndarja e saj nga operatori i aeroportit në vitin 2011, ASHNA ka vjelur një tarifë prej 5.20 eurove/ton (baza: Pesha maksimale e ngritjes së avionit - MTOW), e cila nuk ka qenë e mjaftueshme për të mbuluar kostot e saj. Si pasojë, shteti vazhdimisht ka mbështetur kompaninë e mëparshme Kontrolli Ajror - Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës - Adem Jashari sh.a. me subvencione financiare. Siç u theksua më lart, më 1 janar 2016, në bazë të Ligjit nr. 04/L-250 për Agjencinë e Shërbimeve të Navigacionit Ajror, kompania e mëparshme është transformuar në agjenci shtetërore, gjegjësisht në ASHNA.

Më 19 gusht 2016, AAC-ja ka certifikuar ASHNA-n për një periudhë 5 vjeçare për të ofruar shërbimet në vijim: kontroll të trafikut ajror, navigacion dhe vëzhgim, informata aeronautike dhe meteorologji. Certifikata është lëshuar pas përmbushjes së kërkesave të përbashkëta për ofrim të shërbimeve të navigacionit ajror siç ceket në Rregullore e BE-së nr. 550/2004 për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror në Qiellin e Vetëm Evropian dhe Rregulloren e KE-së nr. 1035/2011 që përcakton kërkesat e përbashkëta për ofrimin e shërbimeve të navigacionit ajror. Të dy këto Rregullore janë transpozuar në legjislacionin kombëtar të Kosovës.

4. Metodologjia dhe parimet e tarifimit

Llogaritja e tarifës njësi për tarifën terminale të navigacionit (TNC) për vitin 2017 ka rezultuar nga zbatimi i metodologjisë së përcaktuar në Rregulloren nr. 3/2016 të AAC-së mbi përcaktimin e skemës së përbashkët të tarifave për shërbimet e navigacionit ajror. Bazuar në këtë metodologji, TNC llogaritet për vitin “n” në bazë të kostove dhe trafikut të vlerësuar për atë vit. Do të zbatohet një mekanizëm i rregullimit për të siguruar që të mbulohen vetëm kostot aktuale të shërbimeve.

Parimi bazë i kësaj metodologjie është që tarifat e rregulluara, siç është TNC, do të mbulojnë të gjitha kostot e shkaktuara nga OSHNA, ato operative dhe kapitale, të nevojshme për të ofruar shërbimet. Në këtë mënyrë, arrihet ekuilibri në të cilin përdoruesit nuk do të paguajnë më tepër se sa kostot për ofrimin e shërbimeve, dhe në anën tjetër, OSHNA do të jetë në gjendje të mbulojë të gjitha kostot e pranueshme për të gjitha shërbimet dhe aktivitetet e pranueshme të kryera si dhe hapësirat e përdorura. Çmimi përfundimtar i shërbimit përcaktohet duke mbuluar të gjitha kostot për shërbimet e ofruara (kontrolli i trafikut ajror, navigacioni dhe vëzhgimi, informatat aeronautike dhe meteorologjia) duke ia shtuar kësaj kthimin e arsyeshëm në investimet e bëra për t’i ofruar këto shërbime.

5. Kostot e pranueshme

Në bazë të Rregullores nr. 3/2016, OSHNA përcakton kostot e shkaktuara nga ofrimi i shërbimeve të navigacionit ajror në lidhje me objektet dhe shërbimet e ofruara. Këto kosto ndahen në:

- Kosto e stafit (pagesa bruto, pagesa për punë jashtë orarit, kontributi i punëdhënësit për skemën e sigurimeve sociale, si dhe kostot e pensioneve dhe përfitimeve tjera);
- Kosto operative (blerja e mallrave dhe shërbimeve për të ofruar shërbime të tilla si komunikimi, konsulentët, materiale, energjia, shërbimet komunale, qiraja, pajisjet e objekteve, mirëmbajtja, kostot e sigurimit dhe të udhëtimit);
- Kosto e zhvlerësimit (që lidhen me asetet fikse në funksion për qëllime të SHNA-s);
- Kosto e kapitalit (produkti i: a) shumës së vlerës mesatare neto të regjistruar në libra të aseteve fikse në funksion apo në ndërtim e sipër të përdorura nga OSHNA dhe të vlerës mesatare të aseteve afatshkurtra të nevojshme për ofrimin e shërbimeve dhe b) mesatarja e ponderuar e normës së interesit mbi borxhet dhe të kthimit nga kapitali);
- Artikujt e veçantë (kostot jo-periodike në lidhje me ofrimin e shërbimeve).

6. Llogaritja e tarifës terminale

Tarifa terminale për një fluturim specifik sipas Shtojcës V të Rregullores është e barabartë me produktin e tarifës njësi të vendosur për këtë zonë të tarifimit terminal dhe njërive të shërbimeve terminale për këtë fluturim. Njësitë e shërbimeve terminale (TSU) llogariten në bazë të formulës:

$$TSU = (MTOW/50)^{0.7}$$

7. Vlerësimi i aplikacionit të ASHNA-s

Me qëllim të vlerësimit të aplikacionit të ASHNA-s për përcaktimin e tarifës njësi TNC për vitin 2017, AAC-ja ka marrë parasysh pikat në vijim:

- Informatat dhe dokumentet e paraqitura nga ASHNA gjatë raportimit të tyre të parë (baza fillestare e kostove përmes përdorimit të Tabelave të Raportimit nga Shtojca II dhe VI e Rregullores) më 31 mars 2016;
- Informatat dhe dokumentet e paraqitura nga ASHNA gjatë raportimit të tyre të dytë (baza përfundimtare e kostove përmes përdorimit të Tabelave të Raportimit nga Shtojca II dhe VI e Rregullores) më 8 shtator 2016;
- Informatat dhe dokumentet e paraqitura nga ASHNA më 29 shtator 2016 për qëllime të Planit Fillestar të Performancës, i cili është dorëzuar më 1 tetor 2016 nga AAC-ja te Organi Shqyrtues i Performancës i KE-së. Për të shmangur çdo huti, ju lutemi vini re se palëve të HPEA-së, duke përfshirë edhe Kosovës, iu është kërkuar nga KE-ja që të hartojnë një Plan Fillestar të Performancës për shërbimet e navigacionit ajror për periudhën 2017-2019, si një ushtrim para Periudhës Referuese 3, kur pritet që të gjitha palët e HPEA-së ta aplikojnë metodën e kostove të përcaktuara.
- Pasqyrat e audituara financiare të Kontrolli Ajror - Aeroporti Ndërkombëtar të Prishtinës Adem Jashari sh.a. - për vitin financiar të përmbyllur më 31 dhjetor 2015;
- Informatat dhe dokumentacioni që kanë dalë nga disa takime të mbajtura ndërmjet ASHNA-s dhe AAC-së, si dhe komunikimi elektronik me qëllim të përcaktimit të tarifës njësi TNC për vitin 2017.

AAC-ja dëshiron të theksojë se aplikacioni i ASHNA-s për përcaktimin e tarifës terminale të navigacionit ka qenë pjesërisht i kompletuar dhe i detajuar. Ndërsa janë plotësuar Tabelat e Raportimit nga Shtojca II (Kostot Totale) dhe VI (Tarifa Njësi) e Rregullores, janë dhënë informata të kufizuara në Raportin Narrativ që shoqëron këto tabela. Në disa raste, ka qenë e vështirë të kuptohet se prej çfarë përbëhet një aset specifik në Listën e Aseteve të ofruara dhe nuk janë ofruar informata se si është llogaritur kostoja e kapitalit, përveç informacionit për normën e përdorur të

kthimit. Në disa prej dokumenteve të vlerësuara gjatë procesit të vlerësimit janë vërejtur pasaktësi dhe mospërputhje. Kjo ka ndodhur pavarësisht ndërhyrjeve të AAC-së gjatë takimeve apo komunikimeve me shkrim për t'u pajisur me informata më të sakta. Pavarësisht kësaj që u tha më lart, AAC-ja ka bërë përpjekje dhe ka angazhuar ekspertizën e nevojshme për të ndërmarrë një vlerësim real të informatave dhe dokumentacionit të ofruar nga ASHNA. Është realizuar një vlerësim gjithëpërfshirës i analizave dhe informatave, i shoqëruar me analiza krahasuese të viteve të mëparshme, si dhe memories institucionale të AAC-së në lidhje me auditimet e sigurisë dhe miratimin e ndryshimeve në ASHNA, për të përcaktuar vlerësimin më real të mundshëm për kostot e përgjithshme dhe trafikun për vitin 2017.

Vlerësimi është bërë duke ndërmarr hapat e mëposhtëm: vlerësimi dhe përcaktimi i kostove të pranueshme (staf, operim, zhvlerësim, kapital), përcaktimi i kapitalit të përdorur, parashikimi i trafikut dhe në fund, përcaktimi i tarifës njësi për vitin 2017. Në vijim është paraqitur procesi dhe rezultati i secilit prej këtyre hapave.

7.1. Vlerësimi dhe përcaktimi i kostove të stafit dhe atyre operative

AAC-ja ka kontrolluar dhe konfirmuar se janë përfshirë në këto dy linja kostosh vetëm kostot e pranueshme për stafin dhe kostot operative siç përshkruhen në nenin 5 më sipër.

Siç tregohet në Tabelën 1, kostot e stafit tregojnë përpjekje për të kontrolluar dhe zvogëluar kostot për njësi, që nënkupton rritje të efikasitetit.

Nga ana tjetër, ASHNA ka propozuar një rritje shumë më të lartë të shpenzimeve operative për vitin 2017, e cila është kufizuar nga AAC-ja në 5% mbi ato të vitit të kaluar. Kjo, për shkak të faktit se regjimi i mbulimit të plotë të kostove të operimit do t'i mundësojë ASHNA-s të mbulojë edhe kostot e zhvlerësimit dhe kostot kapitale.

		2014 A	2015 A	2016 F	2017 F	2018 P	2019 P
Propozimi i ASHNA-s	Stafi	2,087,629	2,252,784	2,240,973	2,238,918	2,375,420	2,400,475
			7.9%	-0.5%	-0.1%	6.1%	1.1%
	Kosto tjera operative	646,348	974,454	569,027	791,388	878,580	903,580
			50.8%	-41.6%	39.1%	11.0%	2.8%
Përcaktimi nga AAC-ja	Stafi	2,087,629	2,252,784	2,240,973	2,238,918	2,375,420	2,400,475
		0.0%	7.9%	-0.5%	-0.1%	6.1%	1.1%
	Kosto tjera operative	646,348	974,454	569,027	597,478	627,352	658,720
			50.8%	-41.6%	5.0%	5.0%	5.0%

Tabela 1. Propozimi i ASHNA-s dhe përcaktimi i AAC-së për kostot e stafit dhe operative

7.2. Vlerësimi dhe përcaktimi i zhvlerësimit dhe kostoja e kapitalit

7.2.1. Baza e aseteve

AAC-ja ka shqyrtuar listën e aseteve të ofruara nga ASHNA për të siguruar se janë përfshirë vetëm ato që janë në funksion, që akoma nuk janë zhvlerësuar plotësisht dhe që janë duke u përdorur për qëllim të ofrimit të shërbimeve për përdoruesit. AAC-ja gjithashtu ka rigrupuar asetet në pesë kategori kryesore, ka vlerësuar periudhën e zhvlerësimit, e cila është përdorur, dhe ka arritur në vlerën korresponduese të bazës së aseteve. Vlerësimi ka shpalosur se shumica e aseteve të ASHNA-s po i afrohet fundit të jetëgjatësisë së tyre operative. Megjithatë, baza e aseteve është rritur për shkak të një projekti të madh investues në vlerë prej 7.8 mil euro në proces që nga viti 2011, siç mund të shihet në tabelën 2 më poshtë, e vendosur si linjë e veçantë *Pajisjet e navigacionit*, për referim më të lehtë dhe për qëllime transparence. Vlera kontabël prej 5,831,752 mil euro në tabelë paraqet pjesën e finalizuar të këtij investimi, i cili është në funksion për përdoruesit aktualisht dhe do të jetë edhe në vitin 2017 e tutje. Ky projekt përfshin pajisjet e mëposhtme: Radarin e ri Mode S, VCSS/VCR dhe DVOR/DME.

Tabela 2 më poshtë tregon vlerën kontabël të aseteve deri më 31 dhjetor 2016, siç është propozuar nga ASHNA dhe rishikuar nga AAC-ja.

Kategoria e aseteve	Njësia	Vlera kontabël sipas ASHNA-s	Vlera kontabël sipas AAC-së
Ndërtesa	€	177,058	177,058
Pajisje	€	121,920	74,387
Orendi	€	229	229
Pajisje të TI-së	€	36,130	36,130
Automjete	€		
Pajisjet e navigacionit	€	6,174,796	5,488,708
Gjithsej	€	6,375,659	5,776,512

Tabela 2. Asetet fikse që do të jenë në operim gjatë vitit 2017 të propozuara nga ASHNA dhe të përcaktuara nga AAC-ja

7.3. Zhvlerësimi

Kostot historike dhe lineare për zhvlerësim janë përdorur në përputhje me Rregulloren.

ASHNA ka llogaritur zhvlerësimin e aseteve të saj si më poshtë:

- Ndërtesat (20 vjet)
- Pajisjet (5-10 vjet)
- Automjetet (5 vjet)

- Pajisjet kompjuterike (5 vjet)
- Orenditë (5 vjet)

Gjatë vlerësimit të saj, edhe AAC-ja ka klasifikuar asetet e ASHNA-s sipas kategorive të mësipërme.

AAC-ja ka pranuar propozimin e ASHNA-s që pajisjet e specializuara elektronike të SHNA-së të amortizohen në një afat kohor prej 5-10 vitesh, pasi që ato po i afrohen fundit të jetëgjatësisë së tyre operative. Megjithatë, për projektin e madh të investimeve të titulluar *Pajisjet e navigacionit*, të cilat kanë hyrë në përdorim më 28 mars 2014, AAC-ja ka paraparë jetëgjatësinë e tyre operative 15 vjet në bazë të shembullit nga Manuali i ICAO-s për Ekonominë e SHNA-së sa i përket pajisjeve elektronike. Çdo aset i ri i prezantuar në të ardhmen, dhe sidomos pajisjet e veçanta elektronike të ASHNA-së, do të rivlerësohen në vazhdimësi bashkërisht nga AAC-ja dhe ASHNA për të siguruar që periudhat e zhvlerësimit që do të zbatohen janë të arsyeshme dhe janë në përputhje me jetëgjatësinë e arsyeshme operative.

Më poshtë është paraqitur vlerësimi i kostove të zhvlerësimit për këto dy kategori: asetet ekzistuese dhe asetet e reja.

7.3.1. Zhvlerësimi i aseteve ekzistuese

Vlerësimi i detajuar nga AAC-ja lidhur me zhvlerësimin e aseteve, të cilat do të shfrytëzohen gjatë vitit 2017 dhe më tutje, ka shpalosur koston e vlerave të zhvlerësimit të paraqitura në tabelën 3 më poshtë.

Asetet para vitit 2017				
Kategoria e asetit	Njësi	2017	2018	2019
Ndërtesa	€	(19,804)	(19,804)	(19,804)
Pajisje	€	(54,034)	(7,280)	-
Orendi	€	(33)	(33)	(33)
Pajisje të TI-së	€	(30,052)	(1,284)	(478)
Automjete	€	-	-	-
Pajisje për navigacion	€	(365,914)	(365,914)	(365,914)
Zhvlerësimi total	€	(469,837)	(394,314)	(386,228)

Tabela 3. Përcaktimi i kostove të zhvlerësimit për asetet ekzistuese

7.3.2. Zhvlerësimi i aseteve të reja

ASHNA ka propozuar një listë të investimeve të reja për t'u kryer gjatë periudhës trevjeçare dhe deri në vitin 2020. Megjithatë, vetëm investimi i parë do të financohet nga fondet vetanake gjatë

periudhës trevjeçare. Pjesa tjetër do të financohet përmes granteve qeveritare, siç shihet në tabelën 4 më poshtë.

Në janar të vitit 2016, ASHNA është zhvendosur në një kullë dhe zyra të reja në objektin e ndërtuar në kuadër të marrëveshjes për Partneritet Publiko-Privat ndërmjet Qeverisë së Kosovës dhe Limak Kosovo International Airport J.S.C. (LKIA) për funksionimin e Aeroportit Ndërkombëtar të Prishtinës për një periudhë prej 20 viteve. Bartja zyrtare në këtë ndërtesë ende nuk është realizuar, por pritet të ndodhë në vitin 2017. AAC-ja është duke e përcjell këtë çështje dhe do të veprojë në përputhje me rrethanat posa të adresohet çështja e pronësisë. Ky aset nuk është përfshirë në bazën e aseteve.

Tabela 4. Lista e aseteve të planifikuara për periudhën e ardhshme 3 vjeçare

Aseti	Kategoria e asetit	Hyrja në shërbim	Vlera totale €	Investimi në vitin 2017 €	Investimi në vitin 2018 €	Investimi në vitin 2019 €
1. Finalizimi i instalimit të sistemit në kullën e re dhe hapësirat për përafrim (<i>approach</i>)	Pajisje	2017	1 719 082	1 000 000	469 082	250 000
2. Sistemi i ri i radios (VHF dhe UHF)	Pajisje	2019	3 900 000	500 000	1 500 000	1 900 000
3. ILS i ri (Sistemi instrumental i aterimit) për avancim (<i>upgrade</i>) në operime Cat III B dhe procedura relevante të fluturimit (APP)	Pajisje	2018	3 130 000	40 000	1 090 000	2 000 000
4. Sistemi i ri për matjen e parametrevë meteorologjik – AWOS, Cat III B	Pajisje	2018	1 880 000	40 000	840 000	1 000 000
5. Sistemi VOLMET dhe vegla e parashikimit (Meteo)	Pajisje	2018	350 000	150 000	200 000	

AAC-ja ka miratuar projektin e parë në tabelën 4, përkatësisht, *Finalizimi i instalimit të sistemit në kullën e re dhe hapësirat për përafrim (approach)*. Miratimet e projektit janë bërë në përputhje me proceset e brendshme vendimmarrëse të ASHNA-s. Aspektet e sigurisë dhe të interoperabilitetit janë shqyrtuar dhe pranuar nga AKM-ja (Autoriteti Kombëtar Mbikëqyrës) e Kosovës. Finalizimi i këtij projekti pritet të ketë ndikim në performancën e sigurisë pasi që projekti i përgjithshëm ka

rezultuar me një riparim të konsiderueshëm të sistemit ekzistues të MTA-së duke përmirësuar kapacitetet e vëzhgimit, rrjetet dhe sistemet e komunikimit si dhe përmirësimin e sistemeve të navigacionit. Ky projekt përfshin: avancimin dhe integrimin e MTA-ve ekzistuese në sistemin e ri të MTA-së, zëvendësimin e transponderit testues MSRR Mode S dhe pjesët rezervë, renovimin e kokës së PSR/MSSR Mode M dhe pjesët rezervë, si dhe pjesët rezervë dhe pajisjet testuese për sistemin e ri DVOR.

Tabela 5 më poshtë paraqet planin e investimeve dhe kalendarin e zhvlerësimit rezultues të investimit të ri (aseteve) në vitin 2017 e tutje.

Asetet e reja					
		Njësia	2017	2018	2019
Koha e përdorimit	15				
2017	1,000,000	€	33,333	66,667	66,667
2018	469,082	€		15,636.07	31,272
2019	250,000	€			8,333.33
	Kostoja e blerjes	€	-	966,667	1,353,446
	Shtesat	€	1,000,000	469,082	250,000
	Zhvlerësimi total	€	(33,333)	(82,303)	(106,272)
	Vlera kontabël neto	€	966,667	1,353,446	1,497,174

Tabela 5. Kostoja e zhvlerësimit për asetet e reja

7.4. Kostoja e kapitalit

Në pajtim me Rregulloren, kostoja e kapitalit është e barabartë me produktin e kapitalit të shfrytëzuar dhe koston mesatare të ponderuar të kapitalit (WACC). Bazuar në Manualin e ICAO-s 9161 për Ekonominë e SHNA-së, kostoja e kapitalit është llogaritur në baza vjetore për tërë kapitalin e investuar në asete fikse, apo shpenzime tjera, të cilat duhet të shlyhen me kalimin e kohës, dhe në kapitalin punues.

Për të llogaritur kapitalin e shfrytëzuar me qëllim të përcaktimit të koston së kapitalit, është përdorur formula e mëposhtme:

$$\text{Kapitali i shfrytëzuar} = \text{vlera mesatare e (aseteve fikse neto + investimet e reja)} + \text{asetet aktuale neto (kapitali punues)}$$

Vlera mesatare e aseteve fikse neto dhe investimet e reja tashmë janë identifikuar gjatë llogaritjes së kostove të zhvlerësimit, ndërsa kapitali punues është përcaktuar në bazë të ndryshimit ndërmjet aseteve aktuale dhe pasiveve aktuale, siç theksohet në pasqyrat e audituara financiare për vitin 2015.

Bazuar në Udhëzimin e EUROCONTROL-it mbi tarifat e rrugëve ajrore: “Kostoja e duhur mesatare e ponderuar e kapitalit (WACC) që do të përdoret është një çështje që Shteti (ose rregullatori tjetër kombëtar ekonomik) duhet ta aprovojë, duke marrë parasysh rrezikun e ulët financiar të ofrimit të shërbimeve të navigacionit ajror. Norma e bonove qeveritare, ose ndryshe normat e pagueshme në tregjet financiare nga ndërmarrjet me rrezik ngjashëm të ulët, mund të merren si udhëzues.”

Formula për llogaritjen e WACC është si më poshtë:

$$WACC = Kthimi\ i\ kapitalit \times \frac{Kapitali}{Borxhi + Kapitali} + Kthimi\ i\ borxhit \times \frac{Borxhi}{Borxhi + Kapitali}$$

ASHNA aktualisht nuk bart ndonjë borxh afatgjatë dhe për këtë arsye kthimi i borxhit nuk i kontribuon ekuacionit të mësipërm. Prandaj, ka mbetur të përcaktohet vetëm kthimi i kapitalit.

Republika e Kosovës nuk ka treg të kapitalit, për këtë arsye është i vështirë përcaktimi i normës së kthimit sipas tregut. Bono me maturitetin më të gjatë që lëshon Qeveria është ajo 5 vjeçare me vlera relativisht të vogla dhe janë vetëm dy shitje të realizuara në vitin 2016 me një normë mesatare të ponderuar prej 2.34%.¹

ASHNA ka propozuar kosto të kapitalit të llogaritur duke përdorur normën mesatare të interesit për kreditë të mbështetura nga depozitat, e publikuar nga Banka Qendrore e Kosovës për vitin 2015 prej 2.85%.² AAC-ja konsideron se një normë më e drejtë e kthimit për rrezik afatgjatë është 3.1%. Kjo është gjithashtu në përputhje me normat e kthimit të përdorura nga vendet fqinje, OSHNA-t e të cilave konsiderohen të kenë po të njëjtin rrezik financiar. Me zgjatjen e periudhës së zhvlerësimit për grupin e fundit të aseteve të përbëra nga pajisjet e navigacionit, në krahasim me atë të propozuar nga ASHNA, kostot kapitale janë zvogëluar, siç tregohet në tabelat 6 dhe 7 më poshtë.

Më poshtë është dhënë vlerësimi dhe përcaktimi i kostos së kapitalit për dy kategori ndarazi: asetet ekzistuese dhe asetet e reja.

¹ Rezultatet e ankandit të datës 25 shkurt dhe 25 gusht 2016 <http://bqk-kos.org/repository/docs/2015/Auction%20Results%2025%20February%202016.pdf> <http://bqk-kos.org/repository/docs/2015/Auction%20Results%2025%20August%202016.pdf>

² Buletini Mujor Statistikor 2016/Nr. 179, f. 59. (15 shtator 2016). Marrë më 9 nëntor, 2016 http://bqk-kos.org/repository/docs/2015/BQK_BMS_179_al..pdf

7.4.1. Kostoja e kapitalit të aseteve ekzistuese

Kostoja e kapitalit të aseteve ekzistuese është llogaritur duke shumëzuar $WACC = 3.1\%$ me vlerën mesatare neto të aseteve ekzistuese duke ia shtuar edhe kapitalin punues. Siç u shpjegua më lart, kapitali punues është i barabartë me ndryshimin ndërmjet aktives dhe pasives aktuale.

Propozimi i ASHNA-së 2.85%	Njësia €	2017 221,069	2018 223,952	2019 219,279
	Unit	2017	2018	2019
Vlera fillestare	€	5,776,512	5,306,675	4,912,361
Shtesat	€	-	-	-
Zhvlerësimi	€	(469,837)	(394,314)	(386,228)
Vlera përfundimtare	€	5,306,675	4,912,361	4,526,133
Vlera mesatare	€	5,541,594	5,109,518	4,719,247
Kapitali punues	€	453,000	453,000	453,000
Asetet duke përfshirë kapitalin punues	€	5,994,594	5,562,518	5,172,247
WACC	%	3.1	3.1	3.1
Kostoja e kapitalit	€	185,832	172,438	160,340

Tabela 6. Kostoja e kapitalit të aseteve ekzistuese siç është propozuar nga ASHNA në krahasim me përcaktimin e AAC-së

7.4.2. Kostoja e kapitalit për asetet e reja

Kostoja e kapitalit për asetet e reja është llogaritur duke shumëzuar $WACC = 3.1\%$ me vlerën mesatare të aseteve të reja.

		Njësia	2017	2018	2019
2017	1,000,000	€	33,333	66,667	66,667
2018	469,082	€		15,636.07	31,272
2019	250,000	€			8,333.33
Kostoja e blerjes		€	-	966,667	1,353,446
Shtesat		€	1,000,000	469,082	250,000
Zhvlerësimi		€	(33,333)	(82,303)	(106,272)
Vlera kontabël neto		€	966,667	1,353,446	1,497,174
Vlera mesatare		€	483,333	1,160,056	1,425,310
WACC		%	3.1	3.1	3.1
Kostoja e kapitalit		€	14,983	35,962	44,185

Tabela 7. Kostoja e kapitalit për asetet e reja

7.5. Kostot totale të zhvlerësimit dhe kostoja totale e kapitalit

Më poshtë janë paraqitur vlerat për zhvlerësimin total dhe kostoja totale e kapitalit siç është propozuar nga ASHNA dhe përcaktuar nga AAC-ja.

		2017 F	2018 P	2019 P
Propozimi i ASHNA-s	Zhvlerësimi	796,913	783,329	773,085
			-1.7%	-1.3%
	Kostoja e kapitalit	379,424	386,136	402,611
			1.8%	4.3%
Përcaktimi i AAC-së	Zhvlerësimi	503,170	476,617	492,500
			-5.3%	3.3%
	Kostoja e kapitalit	200,816	208,400	204,524
			-1.9%	-1.2%

Tabela 8. Zhvlerësimi total dhe kostoja e kapitalit të propozuar nga ASHNA në krahasim me përcaktimin e AAC-së

8. Vlerësimi dhe përcaktimi i kostove totale

Kostot totale për vitet 2017-2019, ashtu siç janë propozuar nga ASHNA dhe AAC-ja janë paraqitur në tabelën e mëposhtme.

		2016 F	2017 F	2018 P	2019 P
Propozimi i ASHNA-s	Stafi	2,240,973	2,238,918	2,375,420	2,400,475
	Kostot tjera operative	569,027	791,388	878,580	903,580
	Zhvlerësimi	784,358	796,913	783,329	773,085
	Kostoja e kapitalit	318,137	379,424	386,136	402,611
	Kostot totale	3,912,495	4,206,643	4,423,465	4,479,752
Përcaktimi i AAC-së	Stafi	2,240,973	2,238,918	2,375,420	2,400,475
	Kostot tjera operative	569,027	597,478	627,352	658,720
	Zhvlerësimi	784,358	503,170	476,617	492,500
	Kostoja e kapitalit	318,137	200,816	208,400	204,524
	Kostot totale	3,912,495	3,540,382	3,687,789	3,756,219

Tabela 8. Kostot totale të propozuara nga ASHNA, në krahasim me ato të përcaktuara nga AAC-ja

Vlen të theksohet se në vitin 2016 nuk ka pasur regjim për mbulimin e plotë të kostove, d.m.th. nuk është aplikuar kostoja e zhvlerësimit dhe/ose kostoja e mbulimit të kapitalit, kështu që, kostot e paraqitura për këtë vit në tabelë janë rillogaritur për të marrë parasysh metodologjinë e Rregullores nr. 3/2016 dhe për të lehtësuar analizat krahasuese.

Grafiku i mëposhtëm ilustron kostot totale për vitin 2017 të propozuar nga ASHNA, në krahasim me përcaktimin e AAC-së:




Figura 1. Kostot për vitin 2017, të propozuara nga ASHNA, në krahasim me ato të përcaktuara nga AAC-ja

Kostot e vlerësuara për operim në vitin 2017, të përcaktuara nga AAC-ja janë 3,540,382 Euro.

9. Parashikimi i trafikut

Numri i TSU-ve është parashikuar në bazë të rritjes historike gjatë viteve të mëparshme, përveç vitit 2014 kur ka pasur një rënie drastike për shkak të daljes nga tregu të një kompanie kyçe ajrore, e cila nuk duhet të konsiderohet si pjesë e trendit.

9.1. Rritja ekonomike dhe inflacioni

Në vitin 2016 filloi të ketë një rimëkëmbje të rritjes ekonomike, pas ngecjes në vitin 2014 që përkoi me një ngërç të zgjatur politik. Kjo rimëkëmbje u bë e mundshme nga remitencat e përsheptuara dhe flukset hyrëse të IHD-ve (investimet e huaja direkte), kreditimit më të lartë bankar dhe eksporteve solide.

Sipas FMN-së, Bruto Prodhimi Vendor (BPV) i Kosovës në çmime konstante pritet të jetë 5,947 miliardë euro (3,400%) në vitin 2016, 6,201 (4,280%) në vitin 2017, 6,456 në vitin 2018 (4.1%) dhe 6.691 (3,650%) në vitin 2019.³

Qeveria e Kosovës sheh një potencial më të fortë të zhvillimit dhe parasheh një rritje afat-mesme të arritshme në normë prej 4.5-5%. Në një vlerësim të realizuar në shtator të vitit 2016 nga Banka Botërore, rritja është paraqitur më e ulët se në secilën prej këtyre vlerësimeve.⁴

Sipas FMN-së, në vitin 2016 pritet inflacion i ulët prej vetëm 0.216% kurse në vitet 2017, 2018, 2019 pritet të jetë 1.533%, 1.782% dhe 1.915%.

9.2. Trafiku ndër vite

Rritja mesatare e numrit të udhëtarëve në Aeroportin Ndërkombëtar të Prishtinës (ANP) gjatë periudhës 2000-2015 ishte 19.37% në vit, ndërsa numri i fluturimeve është rritur për 14.08%. Gjatë kësaj periudhe është rritur ndjeshëm numri i udhëtarëve në fluturime, si rezultat i rritjes së ngarkesës mesatare të udhëtarëve për aeroplan dhe rritjes mesatare të madhësisë së aeroplanëve që operojnë, në linjë me trendet botërore. Në vitin 2015 është shënuar një rritje prej 10.28% në trafikun e udhëtarëve, ndërsa në vitin 2016 deri në muajin tetor është shënuar një rritje prej 11.57%.

³ Raporti për vendet dhe subjektet e përzgjedhura (n.d.). Marrë më 9 nëntor 2016 nga https://www.imf.org/external/pubs/ft/weo/2016/01/weodata/weorept.aspx?sy=2014&ey=2021&ssd=1&sort=countr&ds=.&br=1&pr1.x=59&pr1.y=10&c=967&s=NGDP_R%2CNGDP_RPCH%2CPCPI%2CPCPIPCH&grp=0&a=

⁴ Rritja vazhdon, papunësia mbetet e lartë në Kosovë. (27 shtator 2016). Marrë më 9 nëntor 2016, nga <http://www.worldbank.org/en/news/press-release/2016/09/27/growth-continues-unemployment-remains-high-in-kosovo>




Figura 2. Numri i udhëtarëve në ANP Adem Jashari për periudhën 2000-2015




Figure 3. Numri i fluturimeve në ANP Adem Jashari për periudhën 2000-2015

9.3. Supozimet e trafikut

Shtimi i trafikut në ANP nuk shfaq lidhshmëri të ngushtë me rritjen e BPV-së dhe për këtë arsye nuk është marrë për bazë për qëllime të parashikimit. Në të njëjtën kohë, ASHNA ka qasje në të dhënat historike të TSU-së me qëllim të parashikimit, duke filluar vetëm nga viti 2014. Edhe STATFOR nuk ka mundur të përdoret për qëllime të parashikimit. Kjo është edhe arsyeja se pse janë marrë në konsideratë të dhënat historike për numrat e fluturimeve për qëllime të parashikimit. Gjatë 3 viteve të ardhshme pritet që të ndodhë normalizimi i hapësirës së ulët ajrore, gjë që do të rriste Trafikun e Përgjithshëm Ajror (GAT) brenda vendit dhe do të rriste mbikalimet të cilat kanë qëllim aterrimin në aeroportet e vendeve fqinje. Ky ndryshim pritet të ndodhë në vitin 2017; megjithatë, për shkak të varësisë nga faktorët e jashtëm (NATO), nuk jemi në gjendje të përcaktojmë kohën e saktë të këtij trafiku shtesë.

Skenari bazë është optimist dhe ka parashikuar regjimin e liberalizimit të vizave për qytetarët e Kosovës që udhëtojnë në BE, ndërsa skenari i ulët nuk përfshin liberalizimin e vizave dhe normalizimin e hapësirës së ulët ajrore.

Me një popullsi rezidente prej 1,749 milion, Kosova ka një diasporë të madhe prej rreth 400.000 njerëz, të cilët janë shfrytëzuesit kryesorë të udhëtimit ajror.

9.4. Rritja e parashikuar e trafikut

AAC-ja e ka pranuar si të arsyeshme rritjen e trafikut të propozuar nga ASHNA për vitin 2017 në një vlerë prej 10%, duke marrë parasysh të dhënat historike, parashikimin e operatorit të aeroportit dhe zhvillimet në aeroportet e afërta. Gjithashtu, për qëllime të llogaritjeve, AAC-ja ka pranuar parashikimin e trafikut për vitet 2018 dhe 2019, që është propozuar nga ASHNA (5% rritje në të dy vitet), por ato mund të kenë nevojë për rishikim në bazë të ngjarjeve politike të cilat duhet të rrisin edhe më tej trafikun. Më poshtë është paraqitur një pjesë e shkëputur nga Plani Fillestar i Performancës 2017-2019 i Kosovës për shërbimet e navigacionit ajror, i përgatitur në shtator të vitit 2016 për t'u dorëzuar te Organi për Shqyrtimin e Performancës së Komisionit Evropian.

Njësitë e parashikuara të shërbimit terminal

Aeroporti Ndërkombëtar i Prishtinës		2015 A	2016 E	2017 P	2018 P	2019 P
Baza	Gjithsej njësi shërbimi të terminalit (TSU) të ASHNA-s	8,114	9,250	10,175	10,684	11,218
	Variacionet e TSU-ve nga viti në vit		14.0%	10.0%	5.0%	5.0%
	Parashikimi i njësive të shërbimit terminal sipas AAC-së (skenari bazë)	8,114	9,250	10,175	11,701	12,637
	Variacionet e TSU AAC nga viti në vit		14.0%	10.0%	15.0%	8.0%
	Dallimi në pikë përqindjeje		0	0	10	3
	Dallimi kumulativ në pikë përqindjeje		0.0%	0.0%	-9.5%	-12.6%

E ulët	Parashikimi i njësive shërbimi të terminalit të AACK-së (Skenari i ulët)	8,114	9,250	9,990	10,489	11,014
	Variacionet e TSU AAC nga viti në vit		14.0%	8.0%	5.0%	5.0%
	Dallimi në pikë përqindjeje		0%	-2	-10	-3
	Dallimi kumulativ në pikë përqindjeje		0.0%	1.8%	1.8%	1.8%
Shpjegimi i dallimeve (nëse ka), justifikimi, arsyetimi dhe burimi		STATFOR nuk ofron parashikim për Kosovën. Prandaj, përveç parashikimit që përdoret nga OSHNA, AAC-ja e Kosovës ka bërë skenarin bazë dhe të ulët në bazë të të dhënave historike dhe ngjarjeve të pritura politike.				

10. Tarifa njësi

Tabela e mëposhtme 10 e paraqet tarifën njësi, ashtu siç është propozuar nga ASHNA dhe tarifën njësi të përcaktuar nga AAC-ja. Për vitin 2017, ASHNA ka propozuar një tarifë njësi prej 396.23 euro, që i bie të jetë një rritje prej 39.03%. Kjo është rishikuar nga AAC-ja në 330.75 euro/njësi, një rritje prej 16.05%.

		2014 A	2015 A	2016 F	2017 F	2018 P	2019 P
Propozimi i ASHNA-s	Kostot totale	3,950,014	4,127,097	3,912,495	4,206,643	4,423,465	4,479,752
	Të ardhurat nga burimet tjera		2,648,449	175,000	175,000	175,000	175,000
	Kostot e tarifueshme	3,950,014	4,127,097	3,737,495	4,031,643	4,248,465	4,304,752
	Njësitet e përgjithshme të shërbimit	7,348	8,114	9,250	10,175	10,684	11,218
	Njësitet e tarifueshme të shërbimit	7,384	8,114	9,250	10,175	10,684	11,218
	Tarifa njësi	282.71	285.41	285.00	396.23	397.65	383.74
Përcaktimi i AAC-së	Kostot totale	3,950,014	4,127,097	3,912,495	3,540,382	3,687,789	3,756,219
	Të ardhurat nga burimet tjera	-	2,648,449	175,000	175,000	175,000	175,000
	Kostot e tarifueshme	3,950,014	4,127,097	3,737,495	3,365,382	3,512,789	3,581,219
	Njësitet e përgjithshme të shërbimit	7,348	8,114	9,250	10,175	10,989	11,868
	Njësitet e tarifueshme të shërbimit	7,384	8,114	9,250	10,175	10,989	11,868
	Tarifa njësi	282.71	285.41	285.00	330.75	319.67	301.75

Tabela 9. Tarifa njësi për TNC të Kosovës, e propozuar nga ASHNA, në krahasim me atë të përcaktuar nga AAC-ja

Tarifa njësi prej 285 euro për vitin 2015 është llogaritur si herës ndërmjet tarifave aktuale që i janë faturuar përdoruesve (2,315,817 Euro) dhe njërive totale të shërbimit për atë vit (8114). Të gjitha shifrat tjera për vitet 2014-2016 nuk janë aktuale për shkak se regjimi për mbulimin e plotë të kostove nuk ka qenë në fuqi; ato janë llogaritur për analizë krahasuese. Kostot aktuale të përgjithshme për vitet 2014 dhe 2015 kanë qenë shumë më të larta se tarifat e faturuara për përdoruesit, ku kompania ka operuar me humbje financiare. Megjithatë, shifrat për vitin 2017 e tutje janë llogaritur në bazë të parimeve të Rregullores.

11. Përfundim

ASHNA është duke kaluar nëpër një fazë të transformimit që nënkupton zhvendosjen prej një tarife fikse për disa vite, te një operim me mbulim të plotë të kostove, i shoqëruar me investime të larta kapitale për të mbuluar një periudhë të gjatë të mungesës së investimeve dhe planifikimit për ofrimin e shërbimeve në hapësirën e lartë ajrore. Kjo gjë do të bëjë të domosdoshme një rritje në koston e njësisë gjatë viteve të ardhshme. Duhet të merret parasysh fakti që ASHNA e Kosovës nuk ka të ardhura të tjera të konsiderueshme përveç tarifës TNC për të operuar dhe për t'i mundësuar ASHNA-s të ofrojë shërbime të sigurta dhe cilësore, e në anën tjetër, për të minimizuar barrën për kompanitë ajrore, Qeveria e Kosovës ka intervenuar në disa raste me subvencione financiare. Siç mund të shihet në Tabelën 4, ka pritshmëri të arsyeshme që Qeveria e Kosovës do të vazhdojë të investojë në ASHNA në aspektin afatmesëm, duke ditur vështirësitë që krijohen nëse ASHNA ekziston vetëm nga një burim i të ardhurave.

Edhe pse lejohet me Ligjin nr. 03/L-51 për Aviacionin Civil si dhe me Rregulloren nr. 3/2016 mbi Përcaktimin e Skemës së Përbashkët të Tarifave për Shërbimet e Navigacionit Ajror, AAC-ja është përcaktuar të mos marrë të ardhura nga tarifa e shërbimeve terminale të navigacionit.